

Statistikat mbi fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillim

(GBARD)

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Spektori i Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Olsa Ulqinaku
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës Spektori
1.5. Adresa postare	Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	oulqinaku@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+ 355 (4) 2 2233357/249
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	29.12.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	29.12.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	29.12.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat mbi alokimet e fondeve të buxhetit të shtetit për kërkim dhe zhvillim (GBARD), matin mbështetjen e qeverisë për aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit (K&Zh) dhe në këtë mënyrë, ofrojnë informacion mbi përparësinë që qeveritë i japin aktiviteteve të ndryshme publike të financimit të kërkimit dhe zhvillimit.</p> <p>Të dhënat GBARD paraqiten sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> Objektivave socio-ekonomike (SEOs), në përputhje me Nomenklaturën për Analizën dhe Krahasimin e Programeve dhe Buxheteve Shkencore (NABS 2007); Mënyrës së financimit: financim për projekte dhe financim institucional (të dhëna jo të detyrueshme); Të dhëna mbi koordinimin ndërkombëtar; Të dhënat janë të disponueshme vetëm në njësinë monetare Lekë, e cila është dhe njësia bazë; Konceptet dhe përkufizimet kryesore të përdorura për prodhimin e statistikave të kërkimit-zhvillimit përcaktohen nga Manuali Frascati,

	<p>“Udhëzime për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave mbi kërkimin dhe zhvillimin eksperimental, OECD, 2015”.</p>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Klasifikimi kryesor i përdorur në bazën e të dhënave GBARD është nomenklatura për analizën dhe krahasimin e programeve dhe buxheteve shkencore (NABS 2007). Versioni më i fundit i kësaj nomenklature (NABS 2007) është i zbatueshëm që nga viti referencë 2007.</p> <p>Shpërndarja sipas objektivave socio-ekonomikë (SEO) bazohet në Nomenklaturën për Analizën dhe Krahasimin e Programeve dhe Buxheteve Shkencore (NABS) në nivelin me një shifror (1 digit).</p> <p>Klasifikimet sipas NABS 2007 janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • NABS01: Eksplorimi dhe shfrytëzimi i tokës; • NABS02: Mjedisi; • NABS03: Eksplorimi dhe shfrytëzimi i hapësirës; • NABS04: Transport, telekomunikim dhe infrastrukturë tjetër; • NABS05: Energji; • NABS06: Teknologji dhe prodhim industrial; • NABS07: Shëndetësi; • NABS08: Bujqësi; • NABS09: Edukim; • NABS10: Kulturë, rikrijim, besim fetar dhe media masivemasive; • NABS11: Sisteme politike dhe shoqërore, struktura dhe procese; • NABS12: Avancim i përgjithshëm i njohurive: kërkimi dhe zhvillimi i financuar nga fondet e përgjithshme universitare (FPU); • NABS13: Avancim i përgjithshëm i njohurive: kërkimi dhe zhvillimi i financuar nga burime të tjera fondesh përjashtuar fondet e përgjithshme universitare (FPU); • NABS14: Mbrojtje.
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>GBARD mbulon jo vetëm kërkimin-zhvillimin të financuar nga qeveria dhe të kryer në institucionet qeveritare, por edhe Kërkimin-Zhvillimin të financuar nga qeveria në tre sektorët e tjerë kombëtarë (ndërmarrjet e biznesit, sektori privat jofitimprurës, arsimi i lartë), si edhe pjesën ‘Pjesës tjetër të botës’ (duke përfshirë organizatat ndërkombëtare), (12.16, Manuali Frascati (2015)).</p> <p>Kërkimi-Zhvillimi: INSTAT përdor përkufizimin e Kërkim-Zhvillimit bazuar në Manualin e Frascatit. Ky përkufizim si dhe metodologjia përkatëse u dërgohet njësisë raportuese së bashku me pyetësin.</p> <p>Mbulimi i Kërkimit-Zhvillimit ose i Shkencës dhe Teknologjisë (S&T) në përgjithësi: Mbulon vetëm aktivitetin e Kërkimit dhe Zhvillimit.</p> <p>Objektivi socio-ekonomik (SEO sipas NABS): Përfshin Kërkim-Zhvillimin e financuar nga qeveria, të kryer në institucionet qeveritare, si edhe Kërkim-</p>

	Zhvillimin e financiar nga qeveria që realizohet në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL).
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	<p>Variablat kryesore të mbledhura në kuadër të statistikave GBARD janë si më poshtë:</p> <p>Ndarjet buxhetore të qeverisë për Kërkim-Zhvillim (GBARD): Alokimet e buxhetit të shtetit për Kërkim-Zhvillimit (GBARD), përfshijnë të gjitha fondet e alokuara për Kërkim-Zhvillim nga qeveria qendrore, rajonale dhe vendore. Ato i referohen parashikimeve buxhetore dhe jo shpenzimeve reale. Fondet buxhetore të qeverisjes vendore mund të mos përfshihen në rastet kur kontributi i tyre nuk është i rëndësishëm ose kur të dhënat nuk mund të mblidhen.</p> <p>Financimi i projektit: Financimi për projekte përkufizohet si ajo pjesë e GBARD që u akordohet grupeve ose individëve për realizimin e një aktiviteti Kërkim-Zhvillimit të kufizuar në objekt, buxhet dhe kohë, zakonisht mbi bazën e paraqitjes së një propozimi projekti që përshkruan aktivitetet kërkimore që do të kryhen.</p> <p>Financimi institucional: Financimi institucional përkufizohet si ajo pjesë e GBARD që u alokohet institucioneve pa përzgjedhje të drejtpërdrejtë të projekteve ose programeve të Kërkim-Zhvillimit që do të realizohen. Në këtë lloj financimi, institucioni përfitues ka të drejten për të vendosur mbi projektet e Kërkim-Zhvillimit që do të zbatohen, dhe jo institucioni financues.</p> <p>Financimi publik kombëtar për Kërkim-Zhvillim të koordinuar në mënyrë transnacionale:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Interpretues publikë transnacionalë të kërkim-zhvillimeve; 2. Programeve publike transnacionale të kërkim-zhvillimeve në Evropë; 3. Programeve publike dypalëshe ose shumëpalëshe të kërkim-zhvillimeve.
3.5. Njësia statistikore	<p>Statistikat GBARD mbulojnë të gjitha institucionet publike në territorin e Shqipërisë, Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) dhe OJF-të që mendohen se janë të angazhuara në aktivitetin e kërkim-zhvillimit.</p> <p>Baza e të dhënave administrative për këtë statistikë është përmirësuar gjatë periudhës së referencës, duke reduktuar nënmbulimin. Për të siguruar krahasueshmërinë, njësitë e identifikuara rishtazi janë përfshirë në mënyrë retrospektive edhe në vitet e mëparshme, aty ku aktiviteti është konfirmuar. Janë aplikuar metoda “backcasting” për të zbutur efektet e ndryshimit të mbulimit në kohë, megjithatë mund të mbeten disa dallime. Këshillohet kujdes në interpretimin dhe krahasimin nga një vit në tjetrin.</p>
3.6. Popullata statistikore	Statistikat e Kërkim-Zhvillimit dhe GBARD janë përpiluar për aktivitetin kërkim-zhvillimit të kryer në të gjithë ekonominë. Mbulojnë të gjitha institucionet publike

	në territorin e Shqipërisë, Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) dhe OJF-të që mendohen se janë të angazhuara në aktivitetin e kërkim-zhvillimit.
3.7. Zona e referencës	Institucionet qeveritare, institucionet e arsimit të lartë dhe OJF-të në territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e GBARD në Shqipëri publikohen për herë të parë në vitin 2025, me vit reference 2024.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Njësia matëse për treguesit e prodhuar lidhur me alokimin nga buxheti i shtetit është përqindja, për shpenzimet lidhur me aktivitetin e Kërkimit Shkencor dhe GBARD. Vlerat mblidhen dhe përpunohen në monedhën Lekë.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Periudha e referencës është viti kalendarik 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e indikatorëve për Statistikat e GBARD-it është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Plani vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare. <p>Baza ligjore aktuale në nivel Evropian është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statistikat GBARD bazohen në Rregulloren e Komisionit Nr. 995/2012, e cila zbaton Vendimin Nr. 1608/2003/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të Bashkimit Evropian në fushën e shkencës dhe teknologjisë. • Manuali i Fraskatit, 2015
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Të dhënat transmetohen në Eurostat.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen si repletësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat zyrtare" , si dhe Ligj Nr. 124/2024 për mbrojtjen e të Dhënave Personale . Neni 31, i ligjit "Për Statistikat zyrtare" përcakton qartë që i

	<p>gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikimi i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendarin e publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftimet dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave, specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendarin e publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Aksesin i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018, datë 17.04.2018 “Mbi Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme</p>

	<p>të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Statistikat mbi fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për Kërkim dhe Zhvillim do të publikohen në baza vjetore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me Statistikat e Kërkim-Zhvillimit për treguesit kryesorë.; Formatit i njoftimit për shtyp është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave të Kërkim-Zhvillimit publikohet online në faqen e internetit të INSTAT nën temën: Kërkimi dhe Zhvillimi.
10.2. Publikime	Të dhënat për publikimin "Statistikat mbi Kërkimin-Zhvillimin" gjenden në faqen e internetit të INSTAT në temën Shkencë, Teknologji dhe Inovacion .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat mbi treguesit kryesorë jepen të detajuar sipas klasifikimit NABS 2007 gjendjen dhe në format Excel (Shifrat). Këto tabela mund të gjenden në linkun: Kërkimi dhe Zhvillimi, shifrat .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat e Statistikave të Kërkim-Zhvillimit nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i shpërndahen përdoruesve sipas kriterëve të përcaktuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për kontakt.
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia mbi Statistikat e Kërkim-Zhvillimit është tërësisht e harmonizuar me Manualin e Frascatit 2015, dhe me kërkesat e Eurostat dhe Rregulloren Nr.

	995/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë mbi këto statistika.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Kërkim-Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi Statistikat e Kërkim-Zhvillimit për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat zyrtare Nr.17/2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane . INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Nuk ka publikime të mëparshme.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e treguesve të Statistikave të Kërkim-Zhvillimit ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të Administratës Publike; • Universitete; • Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Biznese; • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>Përdorues të brendshëm janë sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e përdorimit të Statistikave të Kërkim-Zhvillimit input në punën e tyre.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit do të publikohen në web e INSTAT në linkun Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve .

12.3. Plotshmëria	Statistikat e GBARD janë në përputhshmëri të mirë me Eurostat. Kjo përlllogaritje ka marrë në konsideratë indikatorët që kërkohen nga Eurostat bazuar në Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/1148.								
13. Saktësia dhe besueshmëria									
13.1. Saktësia e përgjithshme	Saktësia e përgjithshme e të dhënave të GBARD është përgjithësisht e mirë.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk është e aplikueshme për aktivitetin statistikor, pasi janë të dhëna administrative.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Statistikave të Kërkim Zhvillimit janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 363 ditë pas përfundimit të periudhës referuese 2024. Periudha referuese e rezultateve të Kërkim Zhvillimit është 2024.</p> <table border="1" data-bbox="443 1196 1034 1346"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>31/12/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>29/12/2025</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>363</td> </tr> </table> <p>Të dhënat përfundimtare të GBARD-së i ofrohen Eurostat-it 12 muaj pas përfundimit të vitit kalendarik (dhjetor) dhe synohet të publikohen deri në janar.</p>	Periudha referuese	31/12/2024	Data e publikimit	29/12/2025	Afatet kohore	363		
Periudha referuese	31/12/2024								
Data e publikimit	29/12/2025								
Afatet kohore	363								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Kërkim-Zhvillimit, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve.</p> <table border="1" data-bbox="443 1606 1027 1783"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>31/12/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>29/12/2025</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>29/12/2025</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table> <p>Publikimi i Kërkim-Zhvillimit ka qenë i përpiktë në kohë 100 %.</p>	Periudha referuese	31/12/2024	Data e shpallur	29/12/2025	Data e publikimit	29/12/2025	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	31/12/2024								
Data e shpallur	29/12/2025								
Data e publikimit	29/12/2025								
Vonesa në kohë	0								

15. Koherenca dhe Krahasueshmëria	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat statistikore mbi aktivitetin e kërkimit shkencor dhe statistikat GBARD kryhet në të gjitha vendet evropiane dhe bazohet në përkufizime të harmonizuara ndërkombëtarisht, i cili lejon krahasime midis vendeve të ndryshme të rajonit, BE-së 27 si dhe vendeve EFTA.
15.2. Krahasueshmëria kohore	Të dhënat publikohen për herë të parë.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk ka asnjë vërtetim tjetër apo burim administrativ i krahasueshëm i cili mund të merret si referencë për statistikat e Fondeve të alokuara nga buxheti shtetit për Kërkim-Zhvillim.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Punonjësit që punojnë për Statistikat e Kërkim-Zhvillimit është 1 punonjës në Sektorin e Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të Statistikave të Kërkim Zhvillimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit; • Politika e Trajtimit të Gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi Statistikat e Kërkim Zhvillimit, për vitin 2024 subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i të dhënave janë: Sektori shtetëror, OJF-të dhe Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL).
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen në baza vjetore.

18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat për aktivitetin e kërkimit shkencor dhe zhvillimit në Shqipëri mblidhen dhe prodhohen sipas udhëzimeve të përcaktuara në Manualin e Fracatit si dhe në Rregulloren Europiane të Statistikave të Biznesit. Të dhënat mblidhen përmes shkresave zyrtare, ku janë bashkëngjitur tabelat për plotësim, si dhe metodologjia lidhur me përkufizimet kryesore dhe mënyrën e raportimi. Të dhënat lidhur me statistikat GBARD mblidhen në institucionet kryesore shtetërore, në institucionet e tyre të varësisë ose në institucione ku supozohet se zhvillohen aktivitete kërkimore ose disponohen fonde të alokuara nga buxheti i shtetit, si dhe në të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike të rregullta të ndërthurura realizohen me informacione nga raportimet e viteve të tjera ose nga kërkimet individual në internet dhe krahasimi me vendet e rajonit pasi nuk ekzistojnë burime të tjera në INSTAT për të krahasuar rezultatet e këtyre të dhënave administrative. Në vlerësimin e outputit kontrollohet konsistenca e brendshme e të dhënave para se të finalizohet outputi. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Për përpilimin dhe përgatitjen e rezultateve të studimit janë ndjekur dy procedura bazë. Së pari, është realizuar analiza e cilësisë së të dhënave, me qëllim verifikimin e saktësisë, plotësisë dhe konsistencës së informacionit të mbledhur. Kjo fazë ka shërbyer për identifikimin e gabimeve të mundshme, vlerave të pazakonta apo mungesave në të dhëna. Së dyti, është kryer trajtimi i mos-përgjigjeve, duke marrë parasysh rastet kur të dhënat administrative përmbajnë vlera të munguara ose kur disa elemente të informacionit nuk janë raportuar plotësisht në dokumentacionin përkatës.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet përshtatje sezonale të dhënave.
19. Komentë	
Aneks	